

Vendim nr. 266, datë 22.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (SH) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “ARSENI” SH.P.K, përfaqësuar nga avokat Artens Lazaj, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5424 (489), datë 19.11.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rikthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka blerë nga shoqëria “Neniko Dooel Ljubisa”, përfaqësuar nga shtetasi Ljubisa Zlatevski, markën, emrin, si dhe të gjitha të drejtat për pijen *B-52 Energy Drink*, sipas elementeve përkatëse, në Shqipëri dhe në vendet e tjera ku ajo është e regjistruar si markë tregtare. Kontrata e shitjes është e regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM), sot Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), ku marka ishte regjistruar në datën 06.11.2008, në përputhje me dispozitat e ligjit të kohës nr. 7819, datë 27.04.1994 “Për pronësinë industriale”, me nr. 11992 regjistrimi kombëtar. Ndërsa në datën 14.11.2013 kërkuesja ka paraqitur pranë DPPM-së kërkesë për regjistrimin e transferimit, në favor të saj, të pronësisë së markës ndërkombëtare B-52, me nr. 977607 të regjistrimit dhe kjo drejtori ka dërguar formularin përkatës për regjistrim pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), më 10.04.2014.

2. Me urdhrin nr. 13, datë 15.04.2014, DPPM-ja ka revokuar transferimin e pronësisë së markës ndërkombëtare, duke e lënë atë në pronësi të Ljubisa Zlatevskit dhe duke njoftuar WIPO-n për këtë ndryshim, me arsyetimin se transferimi të kërkuesja ishte kryer gabimisht mbi bazën e një kontrate shitjeje që kishte për objekt një markë tjetër, konkretisht markën kombëtare me nr. 11992 regjistrimi.

3. Kërkuesja ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr. 13, datë 15.04.2014, të DPPM-së në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 4986, datë 22.09.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 13, datë 15.04.2014, të DPPM-së. Sipas asaj gjykate, asnjë nga dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” (ligji nr. 9947/2008), që rregullon veprimtarinë dhe kompetencat e DPPM-së, nuk parashikon mundësinë që ky organ të revokojë aktet e tij, të paligjshme ose jo. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim e paditura, DPPM-ja, dhe personi i tretë, shtetasi Ljubisa Zlatevski.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 345, datë 02.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4986, datë 22.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të njëjtin arsyetim. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kanë ushtruar rekurs DPPM-ja, si dhe Ljubisa Zlatevski, në cilësinë e personit të tretë në gjykim.

5. Me vendimin nr. 00-2022-464 (111), datë 21.03.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se bëhet fjalë për pavlefshmëri absolute, e cila mund të konstatohet nga vetë organi që e ka nxjerrë aktin, në çdo kohë. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkesja nuk kishte interes të ligjshëm material.

6. Në datën 20.07.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-464 (111), datë 21.03.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Gjykata, me vendimin nr. 37, datë 07.07.2023, ka pranuar kërkesën, ka shfuqizuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, pasi ka gjetur shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar. Gjykata ka vlerësuar se cilësimi juridik i urdhrit si absolutisht i pavlefshëm ishte trajtuar vetëm nga Kolegji Administrativ, ndërsa gjykatat më të ulëta nuk ishin shprehur për këtë aspekt, për rrjedhojë Gjykata e Lartë kishte detyrimin të njoftonte palët për t'u shprehur, qoftë edhe me shkrim (*shih paragrafët 30–35 të vendimit nr. 37, datë 07.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, me vendimin nr. 00-2024-5424 (489), datë 19.11.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 345, datë 02.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 4986, datë 22.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë.

8. Në datën 26.05.2025 (data e shërbimit postar) kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 16.06.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

- 9.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, në lidhje me *detyrimin për zbatimin e vendimeve të Gjykatës*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje në rigjykim për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private.
- 9.1.2. *Së drejtës për një vendim të arsyetuar*, pasi duke mos dhënë përgjigje në rigjykim për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private, Gjykata e Lartë ka cenuar edhe këtë të drejtë. Ajo nuk duhej të mjaftohej me një përfundim, por duhej të reflektonte qartësisht analizën logjike dhe juridike mbi të cilën mbështetej vendimi.
- 9.2. *Parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe e drejta e pronës private*, të garantuara nga nenet 11 dhe 41 të Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi edhe marka tregtare përfshihet në të drejtën e pronës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në momentin që DPPI-ja e ka regjistruar aplikimin e shoqërisë “Arseni” sh.p.k., ajo ka fituar pronësinë, e cila mund të ndryshohej vetëm në rrugë gjyqësore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në verifikim të plotësimin të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt ankimi, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar. Në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat

juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij është ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që mban datën mban datën 19.11.2024, i cili, sipas akteve të depozituara me kërkesën, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 27.01.2025, datë në të cilën është bërë i disponueshëm për palët, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 26.05.2025 (sipas shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës për një vendim të arsyetuar, parimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike, si dhe së drejtës së pronës private, të garantuara nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

16. Për sa u përket këtyre pretendimeve, sillet në vëmendje se çështja gjyqësore me palë kërkesen ka qenë edhe më parë objekt shqyrtimi në Gjykatë. Në atë gjykim, Gjykata ka marrë në shqyrtim pretendimet e saj për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t’u dëgjuar, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike, së drejtës së pronës dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike.

17. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë është bazuar në të njëjtat fakte dhe prova si gjykatat më të ulëta, ndaj pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar. Ndërkohë, sa i përket së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve, Gjykata ka çmuar se trajtimi për herë të parë i pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 13, datë 15.04.2014, të DPPM-së, nga Gjykata e Lartë, pa njoftuar palët, ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, duke vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, Gjykata ka vlerësuar se nuk ishte e nevojshme të shprehej për pretendimet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe së drejtës së pronës private, duke qenë se çështja do të merrej përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

18. Në rastin konkret, kërkesja ka pretenduar se gjatë rigjykimit të çështjes Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh detyrat e lëna nga kjo Gjykatë. Sipas saj, vendimmarrja e kundërshtuar e Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike në lidhje me detyrimin për zbatimin e vendimeve të Gjykatës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje në rigjykim për pretendimin për cenimin e së drejtës për një vendim të arsyetuar, si dhe së drejtës së pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike.

19. Duke mbajtur në konsideratë se, nga njëra anë, pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës private janë të ndërvarura me atë për cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe, nga ana tjetër, se kërkesja i ka bazuar këto pretendime në argumentin se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për cenimin e së drejtës së pronës private, Kolegji çmon t'i analizojë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës. Në analizë do të mbahet në konsideratë edhe nëse Gjykata e Lartë ka rishqyrtuar çështjen në zbatim të vendimit nr. 37, datë 07.07.2023 të Gjykatës, vlerësimi i së cilës përbën bazën e arsyetimit të vendimit objekt kërkesë.

20. Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të rëndësishme të ngritura në gjykim nga ajo, duke nisur me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike gjatë rigjykimit, si dhe në lidhje me ndërhyrjen administrative me këtë të drejtë, por duke u mjaftuar me dhënien e një përfundimi pa kryer një arsyetim të plotë dhe të qartë, pra një analizë logjike dhe juridike, mbi bazën e së cilës mbështetet vendimi.

21. Neni 41 garanton të drejtën e pronës private, ndërsa sipas nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Po kështu, nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht për forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë

e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 66, datë 06.12.2023; nr. 49, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkesja ka vënë në lëvizje, procesin gjyqësor të kundërshtuar, e cila i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar, ndër të tjera, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 13, datë 15.04.2014, të DPPM-së. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 4986, datë 22.09.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së kërkueses, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të urdhrit nr. 13, datë 15.04.2014, të DPPM-së.

26. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim e paditura, DPPM-ja, dhe personi i tretë, shtetasi Ljubisa Zlatevski. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 345, datë 02.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4986, datë 22.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të njëjtin arsyetim. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kanë ushtruar rekurs DPPM-ja, si dhe Ljubisa Zlatevski, në cilësinë e personit të tretë në gjykim.

27. Me vendimin nr. 00-2022-464 (111), datë 21.03.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se akti i DPPM-së nuk kishte për qëllim revokimin e një akti të vlefshëm, por konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi administrativ të kundërligjshëm për transferimin e pronësisë mbi markën, sipas nenit 162/2 të ligjit nr. 9947/2008 dhe nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), duke konstatuar se transferimi i pronësisë së markës ndërkombëtare me nr. 977607 regjistrimi, ishte kryer mbi bazën e një kontrate që nuk kishte për objekt këtë markë

28. Po sipas asaj gjykate, kërkesja nuk ka interes të ligjshëm material në ngritjen e padisë, pasi i referohet kontratës së datës 16.06.2010 për regjistrimin e markës kombëtare B-52, me nr. 11992 regjistrimi, ndërkohë që akti i revokimit objekt gjykimi ka të bëjë me një tjetër markë të regjistruar në emër të Ljubisa Zlatevskit që mban nr. 977607 regjistrimi, për të cilën ajo nuk disponon një marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët për transferimin e pronësisë, si kusht i parashikuar në nenin 162/2 të ligjit nr. 9947/2008.

29. Në datën 20.07.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e atij vendimi, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt si dhe të së drejtës së pronës private dhe lirisë së veprimitarisë ekonomike. Gjykata, me vendimin nr. 37 datë 07.07.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2022-464 (111),

datë 21.03.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë. Gjykata ka gjetur shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ka vlerësuar se cilësimi juridik i urdhrin si absolutisht i pavlefshëm është trajtuar vetëm nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndërsa gjykatat më të ulëta nuk janë shprehur për këtë aspekt, për rrjedhojë Gjykata e Lartë kishte detyrimin të njoftonte palët për t'u shprehur, qoftë edhe me shkrim. Gjykata ka çmuar të mos shprehet për pretendimin tjetër të kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, në kushtet kur çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

30. Në vendimin nr. 00-2024-5424 (489), datë 19.11.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar në radhë të parë procedurën gjyqësore të ndjekur. Në këtë rast ajo gjykatë, duke marrë parasysh se çështja është kthyer për rishqyrtim nga Gjykata, ka caktuar për gjykim në mënyrë të përshpejtuar. Krahas shpalljes publike Kolegji ka çmuar të nevojshëm edhe njoftimin e drejtpërdrejtë të palëve ndërgjyqëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes për datën, orën dhe trupin gjykues. Kolegji Administrativ i asaj gjykate, pasi u njoh me aktet e çështjes, në dhomën e këshillimit të datës 04.06.2024, për shkak të specifikave të rastit si çështje e kthyer për rishqyrtim nga Gjykata, si dhe shkaqeve që parashtrohen në rekursin e palës së paditur dhe personit të tretë, ka çmuar nevojën e dëgjimit të palëve në seancë gjyqësore. Për rrjedhojë, kolegji i asaj gjykate, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore, duke urdhëruar njoftimin individual të palëve për datën dhe orën e seancës gjyqësore. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë e ka rishqyrtuar çështjen në zbatim të vendimit nr.37, datë 07.07.2023 të Gjykatës, duke i dhënë mundësi kërkueses të shprehet për pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 13, datë 15.04.2014, të DPPM-së, në përputhje me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, duke marrë parasysh detyrat e lëna nga Gjykata.

31. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se vendimet e gjykatave më të ulëta janë bazuar në një zbatim të gabuar të ligjit material. Thelbi i çështjes lidhej me transferimin e pronësisë mbi markën ndërkombëtare B-52 me nr. 977607 regjistrimi, e kryer nga DPPM-ja mbi bazën e një kontrate shitjeje që kishte për objekt një markë tjetër kombëtare me nr. 11992 regjistri. Ky veprim administrativ është konsideruar nga ajo Gjykatë si një shkelje e nenit 162/2 të ligjit nr. 9947/2008 dhe të nenit 117 të KPA-së.

32. Kolegji i asaj gjykate ka sqaruar se akti i DPPM-së nuk ishte revokimi i një akti të vlefshëm, por konstatim i pavlefshmërisë absolute, pasi kontrata nuk përfshinte objektin e pretenduar. Në këtë kontekst, pavlefshmëria absolute është trajtuar si nulitet që nuk prodhon pasoja

juridike dhe që mund të konstatohet nga organi administrativ në çdo kohë. Jo çdo shkelje procedurale sjell pavlefshmëri, por në këtë rast shkelja ishte thelbësore dhe cenonte vetë të drejtën e pronësisë industriale. Meqenëse veprimi i DPPM-së kishte për qëllim rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, ai konsiderohet i kryer brenda kompetencave ligjore.

33. Kolegji vëren se në të kundërt me sa pretendon kërkuësja në ankimin kushtetues individual, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për sa u takon rrethanave të çështjes, duke u shprehur në këtë mënyrë edhe për cenimin e së drejtës së pronësisë së kërkuëses në lidhje me transferimin e pronësisë mbi markën ndërkombëtare B-52 me nr. 977607 regjistrimi mbi bazën e një kontrate shitjeje që kishte për objekt një markë tjetër kombëtare, me nr. 11992 regjistrimi. Gjithashtu, ai kolegji ka arsyetuar mjaftueshëm për veprimin e DPPM-së, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të tij të mëparshëm për regjistrimin e markës me nr. 977607.

34. Për sa më lart, në kushtet kur pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor, të ngritur nga kërkuësja, në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës për një vendim të arsyetuar është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës dhe të lirisë së veprimitarisë ekonomike, të ndërvarura nga procesi, janë haptazi të pabazuara.

35. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.